



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H E R

Nr. 239 date 30.12 .2003

**PËR
RISTRUKTURIMIN ORGANIZATIV TË PROKURORIVE USHTARAKE DHE
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NGA PROKURORET USHTARAK**

Me synim,

- ristrukturimin organizativ të Prokurorive Ushtarake, ne përjasje me organizimin e Gjykatave Ushtarake të shkallës së parë;
- përmirësimin e menaxhimit të burimeve njërëzore e materjale dhe shpërndarjen më të unifikuar të volumeve të punes në Prokuroritë e shkallës së parë, si dhe;
- për të shmangur vështirësitë që mund të shfaqen në dinamikën e ushtrimit të funksioneve nga prokurorët ushtarak dhe për të siguruar funksionimin normal të tyre;

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J :

1. Ristrukturimin organizativ te Prokurorive Ushtarake, në prohirorë ushtarake ku kanë qendrën dhe ushtrojnë funksionet gjyqtarët ushtarak të shkallës së parë.
2. Prokurorët ushtarak vendosën në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër dhe kënë kompetenca lendore në kufijtë teritorialë¹ të gjykatave ushtarake pranë të cilës ushtrojnë funksionet.
3. Drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor, ku janë vendosur prokurorët ushtarak, mund ti ngarkojë ata, për të ushtruar funksionet në ndjekjen penale ose përfaqësimin e akuzës në gjyq, të procedim eve penale edhe për vepra penale të tjera.

¹ Shih, Dekretin Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 1143 datë 3. 07.1995 "Per caktimin e kufijve tokësorë të veprimtarisë së Gjykatave Ushtarake".

4. Prokurorët e Prokurorive të rretheve gjyqësore dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore pranë tyre, kur marrin dënim për vepra penale ushtarake, të kryera në njësinë territoriale në kompetencë të prokurorëve ushtarak, menjëherë njoftojnë Prokurorinë e rrethit gjyqësor, ku janë vendosur prokurorët ushtarak dhe në rrethana të ngutshme kryejnë të gjitha veprimet e para hetimore të domosdoshme.
5. Në rastet e kryerjes së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit të dyshuarit për vepra penale ushtarake, në rrethet gjyqësore, me përjashtim të rretheve gjyqësore ku vendosen prokurorët ushtarak, në kushtet kur ekziston urgjenca për marrjen e masës së sigurimit¹, mbi kërkesën e Prokurorisë së rrethit gjyqësor, të depozituar në gjykate, prokurori merr pjesë në shqyrtimin gjyqësor të masës së sigurimit dhe i kërkon gjykatës vlerësimin dhe caktimin e saj.
6. Regjistri i procedimeve për vepra penale ushtarake dhe evidencat statistikore, të vazhdojnë të mbahen të veçanta, në zbatim të urdhërit Nr. 284 datë 19. 12. 2002 "Për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në Prokurori" dhe udhëzimit Nr. 289 datë 30. 12. 2002 "Për mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe plotësimit të evidencave statistikore në Prokurori".
7. Strukturat e kësaj Zyre dhe Sekretari i Përgjithshëm, të marrin masat e duhura, për të përmbushur detyrimet përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë urdhër, lidhur me ristrukturimin e Prokurorisë Ushtarake, sistemimin e arkivave të tyre, sistemimin e prokurorëve ushtarak në ambiente të* përshtatshme në Prokuroritë e rretheve gjyqësore të caktuara në këtë urdhër, trajtimin administrativ të tyre, si dhe fillimin e veprimtarisë normale të prokurorëve ushtarak.
8. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen drejtuesit e Prokurorisë të rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë e Gjirokastrë dhe drejtuesit e strukturës së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorisë të të gjithë niveleve, si dhe drejtuesit aktual të Prokurorisë Ushtarake deri në përfundimin e ristrukturimit.
9. Urdhëri Nr. 2 datë 20. 07. 1995 "Për organizimin, strukturën organizative, funksionimin dhe kompetencat e prokurorisë ushtarake¹", me përjashtim të pjesëve ku bëhet fjalë për Prokurorinë Ushtarake të Apelit dhe udhëzimi Nr. 1 datë 10. 01. 1996 "Për disa veçori të funksionimit të Prokurorisë ushtarake", si dhe çdo akt tjetër normativ i Prokurorit të Përgjithshëm që bie në kundërshtim me kërkesat e këtij urdhëri, shfuqizohen.

¹ Shih po aty neni 244/2.

10.Me këtë urdhër të njihen prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjithë niveleve.

11.Ky urdhër hyn në fuqi në datën 1 janar 2004.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

THEODHORI SOLLAKU

